



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

Procesverbal nga mbledhja e XXVI-të (njëzetegjashtë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 10 tetor 2024

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, dhe filloi në orën 10:05

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, z.Demokrat Hodolli, znj.Fikmete Qurkollli.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe; Liman Zeqiri-shef i Zyrës Komunale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK; Selman Gashi nga Drejtoria e Arsimit-DKA; Arbresha Bashota nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS; Driton Shabani nga Stacioni i Policisë në Podujevë; Bekim Karaxhija përfaqësues i OSBE; Zita Rasztik përfaqësuese e KFOR.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroj mirëseardhje në këtë mbledhje, ndër të tjera, theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë, andaj në vazhdim po i lexoj rendin e ditës dhe njëkohësisht pyes nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim rendin e ditës.

Njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e Komitetit, miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 06.09.2024

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth këtij procesverbali, nëse e hedh në votim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 06.09.2024.

2. Informatë e DKA-së për shqyrtimin e mundësive për organizimin e kurseve për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë të cilët kanë vështirësi në shkrim lexim.

z.Selman Gashi, zyrtar në DKA-Podujevë, theksoi, Drejtoria e Arsimit në kuadër të mundësive që ka do të shqyrtoj mundësin e organizimit së kurseve për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë.

Siç e dini edhe ju DKA ka pranuar edhe tutor në shkollat ekzistuese të Komunës së Podujevës që janë shkolla “Ibrahim Rugova”, “Shaban Shala”, “Xheladin Rekaliu”, “Enver Maloku” dhe besoj që këta tutor do të ndikojnë relativisht shumë në organizimin ndoshta edhe të këtyre kurseve për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë që kanë vështirësi në shkrim-lexim. Po ashtu Drejtoria e Arsimit ka pranuar edhe asistent për fëmijë me nevoja të veçanta në kuadër të shkollave në rast që ndonjë fëmijë i komuniteteve ka vështirësi do të merret në trajtim nga asistenti që është për fëmijë me nevoja të veçanta në Komunën e Podujevës, më saktë dje e kemi vlerësuar që një fëmijë ka probleme me dëgjim dhe si rezultat i kësaj ka mbetur mbrapa edhe me shkrim-lexim, pra ne si DKA do të rekomandojmë që me atë fëmijë të merret asistentja për fëmijët me nevoja të veçanta.

Po ashtu ju inkurajojmë edhe juve si përfaqësues i komunitetit jo shumicë dhe në përgjithësi komunitetin që të përcjellin konkursin për bursa e që besoj nuk do të jetë shumë larg dhe do të hapet dhe ne si Drejtori do të kemi parasysh që studentet nga radhët e komunitetit do t’i favorizojmë në aspektin që t’ju ndihmojmë rreth studimeve të tyre, sa për rikujtim edhe në vitet e kaluar kur ka pasur student të komuniteteve jo shumicë ne si komision i kemi shqyrtuar lëndët e tyre dhe e kemi bërë më të mirën që anëtarët e komunitetit të jenë përfitues të bursave në mënyrë që t’ju ndihmojmë në shkollimin e tyre.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, faleminderit parafolësit zyrtar i DKA-së për këto informata që i paraqite. Edhe më parë por edhe tani gjithmonë Komuna dhe Drejtoria e Arsimit ka bërë për komunitet jo shumicë sa i përket mësimin shtesë për ata nxënës që kanë mbetur mbrapa me mësim, prandaj gjithmonë Qendra për aftësim shtesë na kanë ndihmuar.

Sa i përket informatës që e paraqiti parafolësi për një nxënës në shkollën në shkollës “Xheladin Rekaliu”, nuk e kam ditë që në atë shkollë është edhe një Qendër mësimore dhe qenka shumë mirë kjo, ne e kemi ditë vetëm për tutorët në këto dy shkollat, andaj besoj se nxënësit nga radhët e komuniteteve jo shumicë do të shkojnë në atë shkollë dhe do të kërkojnë ndihmë nëse është e nevojshme. Edhe njëherë e përsërisë se është mirë që mësimdhënësit e këtyre tri shkollave të kenë informim lidhur me tutorët dhe të krijohen mundësi, është mirë të sugjerohen nxënësit të cilët janë më të dobët me mësim për t’i vijuar mësimet dhe për t’i përcjellë mësimet e tyre në mënyrë që ne ta dimë gjendjen e secilit nxënës e pastaj të veprojmë te prindërit e tyre nëse ata nxënës nuk vijnë mësimet shtesë. Sa i përket bursave gjithmonë komuna na ka ndihmuar sepse kanë fituar gjithherë bursa nxënësit nga radhët e komuniteteve jo shumicë, mirëpo këtu prezentë kemi edhe një studente nga radhët e komuniteteve jo shumicë që është pjesë e këtij Komiteti nga e cila kërkoj që ta përcjellë procedurën e konkursit për aplikim për bursë dhe t’i informoj të tjerët.

z.Selman Gashi, zyrtar në DKA, theksoi, sa i përket njoftimit të mësimdhënësve, në momentin kur janë pranuar tutorët ata detyrë e kanë të bëjnë identifikimin e fëmijëve që kanë probleme me shkrim lexim dhe vështirësi në mësimnxënie, mirëpo pavarësisht kësaj pas këtij takimi që jemi do t’iu sugjeroj drejtorëve të atyre shkollave ku janë tutorët që të bëjnë njoftimin edhe njëherë lidhur me këtë çështje për angazhim të fëmijëve që kanë probleme që u cekën.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, z.Faik Tahiri ka një vajzë që ka probleme me dëgjim, ka ardhë tek unë dhe më ka pyetur se si mund të bëhet një zgjidhje.

z.Selman Gashi, zyrtar në DKA, theksoi, jemi në procedurë dhe vendimi veç është marrë, tani do të dërgojmë rekomandimin në shkollë.

3. Informatë nga DHSMS, në koordinim me ZKKK-në mbështetur nga OSBE, trajnime për zbatimin e planit të veprimit komunal për avancimin e të drejtave të komuniteteve jo shumicë me temat;

- *Ofrimi i programeve trajnuese dhe edukative për shëndetin.*
- *Informomi i komuniteteve jo shumicë për mundësitë e marrjes dhe llojet e shërbimeve shëndetësore.*

znj.Arbrësja Bashota, zyrtare në DSHMS-Podujevë, theksoi, ne si Drejtori jemi duke punuar sa i përket komuniteteve jo shumicë, së pari po e ceku punën e strehimit, ne kemi shumë kërkesa nga qytetarët për sigurimin e kushteve të banimit, për ndërtim të shtëpive dhe prej 5 shtëpive që kemi bërë zgjidhjen e banimit së bashku me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit” 1 familje është nga radhët e komunitetit jo shumicë shtëpia e të cilit është duke u ndërtuar dhe ka mbet vetëm rregullimi me rrymë, ujë, dyer, dritare dhe mobilim, familje për të cilën Komuna ka ndarë 10,000.00€. Gjithashtu ne kemi bërë edhe rregullimin e shtëpisë së një familjari nga radhët e komunitetit jo shumicë duke përfshirë edhe mobilimin e shtëpisë.

Sa i përket subvencioneve me barna janë ndihmuar disa anëtar të komuniteteve jo shumicë, ndërsa sa i përket ndarjes së pakove ushqimore ne gjithmonë i’u ndihmojmë, po ashtu rrth vizitave mjekësore në QKMF, kemi vizita e sidomos tash që është sezona e vaksinimit dhe mamografisë, janë duke u bërë vizita të rregullta. Pra këto ishin disa informacione në pika të shkurtra, por nëse ka ndonjë pyetje apo kërkesë për sqarime e të ngjashme urdhëroni.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK-Podujevë, theksoi, ne e dimë që Plani i veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve jo shumicë në Komunën tonë, në bazë të një pune voluminoze që kemi bërë është një Plan për avancimin e të gjitha të drejtave, qoftë në shëndetësi, arsim, infrastrukturë, strehim, banim, punësim, kulturë, që merret me të gjitha sferat e jetës që ne bashkëjetojmë.

Duke parë Strategjinë e Qeverisë së Kosovës që e kemi si bazë, atëherë ne jemi obliguar që edhe këtë Plan të veprimit ta krijojmë si plan të veçantë në kuadër të Komunës ku në kuadër të tij ne kemi vepruar dhe punuar në mënyrën më të mirë me Ekipin tonë që de-fakto ka qenë një plan i shkruar mirë të cilin ne duhet ta zbatojmë.

Sa i përket çështjes së zbatimit të Planit duke e falënderuar OSBE-në e cila na ka mbështetë në sektorin e shëndetësisë ne do të vazhdojmë edhe në sektorët tjerë dhe kemi paraparë që t’i kemi dy pika jashtëzakonisht të rëndësishme e për këtë kanë qenë pjesëmarrës anëtarët e komuniteteve jo shumicë në atë takim që e kemi mbajtur për çka falënderoj 2 mjekët që kanë ligjëruar në atë takim i cili është zhvilluar në bashkëpunim me DSHMS për çka po ashtu falënderojmë shumë edhe drejtoreshën e kësaj Drejtorie për kontributin e saj, pra ZKKK në bashkëpunim me DHSMS-në kemi arritur t’i mbajmë këto ligjërata ku prezantimet i kanë bërë 2 mjek, dr.Makfire Abdullahu dhe dr.Shaip Aliu, temat kanë qenë jashtëzakonisht interesante, qëllimi i trajnimit ka qenë situata shëndetësore sociale, cilësia e shërbimit në QKMF dhe qasjes ndaj sistemeve shëndetësore dhe sociale pa diskriminim të komuniteteve jo shumicë në shërbim të gjithë qytetarëve.

Dihet që mjekësia është në shërbim të të gjithë qytetarëve pa diskriminim sepse është edhe çështje humane, objektivi kryesor ka qenë krijimi i kushteve cilësore të qëndrueshme higjienike, sociale, sanitare dhe mjedis për përshtatshëm të ambientit sepse higjiena personale dhe ambienti luajnë një rol të rëndësishëm e për këtë unë i falënderoj edhe të tjerët për mirëkuptim. Tema ka qenë krijimi i kushteve e në veçanti sigurimi i ujit të pijshëm që është një prej faktorëve kryesor për mirëmbajtje e higjienës dhe shërbimet tjera, ofrimi i programeve trajnuese dhe edukative për shëndetin dhe higjienën personale ka qenë temë të cilës duhet ti qasemi në mënyrë sistematike dhe duke i falënderuar mjekët të cilët i përcjellin këto tema që nga cikli i ulët deri në ciklin e lartë të arsimit

mbajnë ligjërata për higjienën personale edukative që përfshinë një term të gjerë sepse kemi nevojë për informacione sidomos nga mjekët profesional që rrjedh nga ta.

Objektivi kryesor është mundësia e marrjes së shërbimeve sociale përmes ndarjes së informacioneve përfshirë skemat e ndihmës dhe ofrimin e shërbimeve në forma të barabarta dhe në përputhje me nevojat, shumë qytetar këtu nuk e dinë ofrimin e shërbimeve në QKMF, por normalisht kemi edhe 4 qendra tjera që punojnë 24 orë ku qytetarët mund t'i marrin barnat e tyre sepse kostoja e tyre ka një çmim të lartë dhe qytetarët duhet të informohen pavarësisht nga përkatësia etnike që ajo që u takon sipas nevojës mund të shërbehen dhe t'i marrin informacionet përmes këtyre mjekëve që kanë ligjëruar sepse në atë takim kanë qenë prezent edhe anëtar të Komitetit për Komunitete.

Pastaj ofrimi i shërbimeve sociale përmes përfshirjes në skemat ekzistuese, ne e dimë që skemat ekzistuese tash kanë ndryshuar me statut skemat sociale ku e falënderoj drejtoreshën e QPS-së që i ka dhënë informacionet për të gjitha ato familje që nuk i kanë kushtet e mira, që jetojnë në gjendje të rëndë ekonomike e sociale dhe ata njerëz që janë të paftë për punë, skemat janë për 170 shërbime që janë në QPS dhe në kuadër të kësaj janë edhe zyrtarët kompetent që merren me këtë çështje dhe gradualisht ne po vijmë deri te reforma dhe për këtë e falënderoj Ministrinë përkatëse dhe QPS-në, që janë marrë me skemat sociale dhe normalisht që në të ardhmen të vetëdijesohen gjithë ata persona që janë të aftë për punë të mos jenë të varur nga skemat sociale, kurse ata që nuk kanë mundësi të punojnë edhe në aspektin shëndetësor dhe në aspektet tjera duhet të ndihmohen.

Informimin e komuniteteve jo shumicë për marrjen e shërbimeve ne e kemi përkrahë dhe prapë e them për këtë projekt që kemi ndërmarrë e falënderoj shumë mbështetjen e OSBE-së sepse çdo herë na ka ndihmuar, përkrahur e mbështetur, andaj ne si Komunë duhet të jemi mirënjohës ndaj tyre për të gjitha punët dhe mbështetjen e ofruar në vazhdimësi ndaj nesh.

Në koordinim me OSBE-në, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete dhe unë kemi vizituar lagjen e komunitetit ashkali në fshatin Batllavë ku jemi pritur jashtëzakonisht mirë dhe në atë kuptimin solidar do ta quaj nga këto pika që i kemi marrë si referencë në këtë donacion të dhuruar nga OSBE-ja, ne i kemi përkrahë dhe janë shpërnda 12 pako higjienike në secilën familje dhe për këtë shprehi një falënderim të veçantë për OSBE-në.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, e falënderoj për kontributin e dhënë OSBE-në dhe mjekët që kanë qenë ligjërues në atë takim sepse vërtetë kemi pas nevojë për atë takim dhe informim për disa gjëra që kanë qenë esenciale dhe këto ne i kemi përcjellë te anëtarët e familjes si dhe në lagjet ku jetojmë, prandaj ju falënderoj shumë.

4. Të Ndryshme

z.Xhafer Ademi, Kryesuesi i Komitetit, theksoi, sa i përket largimit nga skema sociale me të vërtetë komunitetet jo shumicë më së shumti kanë jetuar me ndihma sociale dhe tani kemi një vetëdijesim sepse në lagjen tonë ku jetoj janë punësuar 12-13 anëtar të komunitetit tonë të cilët më parë kanë qenë në skemën sociale, të gjithë këta janë larguar nga skema sociale tani të gjithë janë punësuar në një fabrikë të metalit në Prishtinë e kjo është e mirëseardhur edhe për shtetin edhe për familjet që punojnë.

znj,Shkurte Sejdiu, theksoi, vetëm dua t'ju njoftoj që do mbahet një trajnim / kurs për komunitetet jo shumicë që ka të bëjë për kompjuterizim dhe programin CL, andaj secili nga ne t'i informon të rinjtë që dëshirojnë të marrin pjesë në këtë trajnim.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, këtë e potencova me shkas të çështja e punësimit sepse para disa ditëve isha në takim me shefat e ZKKK, me Kryeministrin dhe Ministrin e Ministrisë së

Administrimit të Pushtetit Lokal z.Elbert Krasniqi, ku të gjitha temat kanë qenë në kuadër të çështjeve që ne këtu i diskutojmë e të cilat i ceka edhe më herët, por atë që unë po e ceku është çështja e punësimit sepse të thuash sot nuk po gjej punë është pak sa interesant sepse këtë e potencoi Kryeministri se nga Bangladeshi, Nepali, Filipinet po gjejnë punë në tregun tonë Kosovare dhe është kërkesë e tregut të lirë, andaj ne këtë duhet ta kuptojmë se të gjithë nuk mund të punojmë në Institucione sepse ka njerëz që kanë zanate dhe kërkohet tregu i lirë dhe të gjithë ata që janë të aftë për punë sot mund të gjejnë hapësirë të punojnë në organizata private që çdo ditë kërkojnë punëtor. Kur vijnë punëtor prej shteteve tjera dhe neve na u bëhet barrë strehimi dhe banimi dhe normalisht ata i paguajnë shërbimet, atëherë ne këtu që bashkëjetojmë mund të gjejmë punë edhe në organizatat private sepse është kërkesë e tregut.

Faleminderit shumë i nderuar Kryesues për informatën që 13 persona të komunitetit jo shumicë janë duke punuar në ndërmarrje private dhe këtu ka filluar vetëdijesimi qytetar, e sidomos pas liberalizimit të vizave shumë qytetarë kanë depërtuar në vendet e perëndimit. Ajo që neve na brengos është se kuadrot më të mira të këtij vendi kanë depërtuar në vendet perëndimore dhe ne duhet ta krijojmë vetëdijen që ta duam këtë vend, të punojmë për këtë vend dhe të ambientohemi me këtë vend dhe me ato paga që kemi sepse shteti kështu zhvillohet vetëm me punë, andaj i inkurajoj të gjithë qytetarët të kërkojnë punë ngase do të gjejnë sepse sot askush nuk mund të thotë nuk po gjej punë, e kam fjalën për sektorin privat kurse ana tjetër institucionale janë konkurset dhe të gjithë ne në zyre nuk mund të punojmë, andaj ne më shumë duhet ta shohim prizmin tonë në sektorin privat.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, është mirë me thirr drejtorin e Entit të Punësimit në mënyrë që të informohemi rreth kërkesave për punësim si dhe për mundësinë e trajnimeve për tregun e punës sepse janë disa të rinj që mund të hyjnë në tregun e punës të cilët në rast se kanë ndonjë zanat mund të kyçen më shpejtë në punë.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, në takimin e ardhshëm do e bëjmë ftesën sepse është mirë ne me i pas informacionet e sakta për ato që ju i thatë ngase kemi Zyrën e Punësimit që enkas merret me këtë çështje, e kanë programin dhe planin e tyre për zanatet e tyre, prandaj ne do e kemi si pikë të rendit të ditës në mbledhjen e radhës.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse edhe ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Meqë nuk kishte të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komiteti e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:35

**Procesverbalin e mbajti,
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0067632/24
Podujevë, 10 tetor 2024**

**Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi**